

## **RAPORT I SHKURTËR**

### **PËR**

# **NIVELIN E ZBATUESHMËRISË SË LIGJEVE TË CILAT MBROJNË DHE RREGULLOJNË TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**PRISHTINË, 2017**

## PARATHËNIE

HANDIKOS (Shoqata e paraplegjikëve dhe e paralizës së fëmijëve të Kosovës), shoqatë e personave me aftësi të kufizuara në vazhden e punës së saj në përparimin e të drejtave dhe pozitës së personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës, vazhdon të punoj në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, duke marrë pjesë aktive në proceset e hartimit dhe konsultimeve publike të politikave dhe legjislacionit për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të monitorimit të zbatimit të ligjeve dhe dokumenteve tjera.

Me këtë raport synojmë të rrisim nivelin e zbatimit të ligjeve në fuqi, që kanë të bëjnë me të drejtat dhe përfitimet tjera për personat me aftësi të kufizuara, familjet e tyre, si dhe të sensibilizojmë së pari vetë personat me aftësi të kufizuara, shoqërinë dhe autoritet publike zbatuese të ligjeve për rëndësinë e zbatimit të ligjeve.

Metodologjia e punës së këtij raporti, bazohet në informatat nga puna e përditshme e HANDIKOS-it në përcjelljen e zbatimit të ligjeve që rregullojnë të drejtat dhe interesat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe nga vetë personat me aftësi të kufizuara të cilët paraqesin shqetësimet e tyre për vështirësitë në realizimin e të drejtave.

Nga analiza e ligjeve, kemi hasur se ligjvënësi në shumicë e prej tyre, shumë çështje i ka lënë për rregullim më të detajuar me aktet nënligjore, e me këtë mënyrë edhe zbatimi i plotë i ligjeve varet nga nxjerrja e akteve nënligjore.

Identifikimi i akteve nënligjore të parapara për nxjerrje të tyre është bërë nga ligjet, ndërsa për nxjerrjen e tyre jemi shërbyer me botimin elektronik të Gazetës Zyrtare, i cili për secilin ligj i ka të renditura edhe aktet nënligjore të ligjeve përkatëse, në disa raste jemi shërbyer edhe me publikimet në ueb faqet e ministrive.

## **LIGJET E FUSHËS SË MBROJTJES SOCIALE:**

### **LIGJI NR. 05/L-067 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK**

Pas një angazhimi të HANDIKOS-it dhe një procesi mbi katër vjeçar, ligji është miratuar më 25 maj 2016, ndërsa ka hyrë në fuqi më 1 korrik po të atij viti, me përjashtim të dispozitave nga nenet 7, 8, 9 dhe 13 (paragrafi 3 dhe 4) - kompensimet dhe benefitet, të cilat ligji i ka caktuar të fillojnë të zbatohen nga 1 janari i vitit 2017.

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë statusin dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor. Ndërsa, fushëveprimi i tij është përcaktimi i të drejtave në beneficione të përfituesve të këtij ligji si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave.

Ligji ka paraparë nxjerrjen e disa akteve nënligjore të cilat e lehtësojnë zbatimin e tij dhe ka caktuar afatin prej gjashtë (6) muajve për nxjerrjen e tyre. Akti i parë nënligjor, Udhëzimi Administrativ (MPMS) Nr.01/2017 për formën dhe përbërjen e librezës zyrtare identifikuese si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, është nxjerrë më 30 janar 2017, ndërsa akti tjetër nënligjor, Rregullorja (QRK) Nr. 07/2017 për përbërjen, funksionimin, përgjegjësitë e komisionit vlerësues dhe përcaktimin e procedurave për njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjik dhe tetraplegjik, është miratuar në Qeveri më 26 maj 2017. Këto dy akte nënligjore janë nxjerrë dhe miratuar më vonë se koha e caktuar me ligj, i pari vetëm me një muaj vonesë, ndërsa akti i dytë me një vit vonesë prej hyrjes në fuqi të ligjit. Ndërsa së fundi është nxjerrë edhe vendimi për caktimin e shumës mujore të kompensimit për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, si dhe për kujdestarin personal, sipas vendimit kjo shume do të jete 150 euro për personin po aq edhe për kujdestarin personal.

Për kompletimin e akteve nënligjore të parapara me ligj, deri më tani kanë mbetur pa u nxjerrë, një akt nënligjor për çështjet e sigurimit shëndetësor, pajisjeve ndihmëse, rehabilitimit fizikal dhe shërbimeve shëndetësor falas.

Ligji e autorizon Qeverinë dhe ministritë e linjave që, të nxjerrin edhe akte tjera nënligjore nëse do të paraqitet nevoja për zbatim të duhur të ligjit.

Një tjetër shkak për mos fillim të zbatimit të këtij ligji është edhe mos buxhetimi i tij, përkatësisht mos ndarja e mjeteve të nevojshme për zbatim të ligjit, qoftë me vijë të veçantë buxhetore apo në kuadrin e vijave buxhetore të pensioneve për personat me aftësi të kufizuara.

Në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, është krijuar vija buxhetore për kompensimet për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Deri në kohën e hartimit të këtij raporti, janë nxjerrë vetëm dy akte nënligjore, vendimi për shumën mujore të kompenzimit, është krijuar vija buxhetore, janë emëruar komisionet konziliare, kanë filluar pranimet e aplikacioneve të personave që kërkojnë njohjen e statusit dhe të drejtave nga ky ligj dhe ka filluar punën Komisioni Vlerësues, ndërsa deri më tani nuk është nxjerrë asnjë vendim për njohjen e statusit dhe të drejtave, me ç'rast asnjë person nuk ka filluar ta gëzojë kompensimin.

## **LIGJI NR. 04/L-092 PËR PERSONAT E VERBËR**

Ky ligj është miratuar më 14 qershor 2012, ndërsa ishte caktuar të fillonte të zbatohet nga 1 janari i vitit 2013.

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë statusin ligjor të personave të verbër në Republikën e Kosovës, ndërsa fushëveprimi i tij është rregullimi i të drejtave dhe përfitimeve si dhe përcaktimi i kritereve për kategorizimin e personave të verbër.

Ligji ka paraparë nxjerrjen e disa akteve nënligjore të cilat e lehtësojnë zbatimin e tij dhe ka caktuar afatin prej gjashtë (6) muajve për nxjerrjen e tyre. Akti i parë nënligjor, Rregullorja Nr. 01/2013 për funksionimin e komisionit mediko-social, është nxjerrë më 24 maj 2013, për t'u shfuqizuar më vonë nga Rregullorja (MPMS) Nr.02/2013 për funksionimin e komisionit mediko-social dhe procedurat e aplikimit për realizimin e të drejtave për personat e verbër, e cila është nxjerrë më 16 dhjetor 2013. Këto dy akte nënligjore janë nxjerrë më vonë se koha e caktuar me ligj, i pari me tre muaj vonesë, ndërsa akti i dytë i cili e zëvendëson të parin është nxjerrë një vit e gjysmë pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Për kompletimin e akteve nënligjore të parapara me ligj, deri më tani kanë mbetur pa u nxjerrë aktet nënligjore për çështjet e sigurimit shëndetësor dhe kujdesit shëndetësor, edukimit dhe arsimit, rehabilitimit, udhëtimit, energjisë elektrike, telefonisë etj, me ç'rast këto dispozita të ligjit që rregullojnë këto fusha shumë të rëndësishme për personat e verbër, kanë mbetur pa u zbatuar deri më tani, pra edhe pas 5 viteve nga miratimi i ligjit.

Nga ky ligj zbatohet vetëm dispozita e kompensimeve për personat e verbër dhe për shoqëruesit e tyre, edhe kjo me shumë vërejtje dhe pakënaqësi tek personat e verbër.

Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, në vitin 2015 e ka mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji dhe ka nxjerrë një raport me rekomandime të cilin Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar.

## **LIGJI NR. 03/L-019 PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 05/L - 078**

Ky ligj është miratuar më 18 dhjetor 2008, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 05/L-078 më 5 gusht 2016.

Ky ligj ka për qëllim përkrahjen ligjore dhe institucionale për aftësimin, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara duke u mbështetur në principet dhe tretmanin e mundësive të barabarta përfshirë edhe mundësitë gjinore.

Ndërsa, fushëveprimi i tij është rregullimi dhe përcaktimi i të drejtave, kushtet, mënyrat e aftësim, riaftësim profesional dhe punësimi i personave me aftësi të kufizuara, për integrimin e tyre në tregun e hapur të punës sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në legjislationin e aplikueshëm.

Ligji ka paraparë nxjerrjen një morie të akteve nënligjore, të cilat e lehtësojnë zbatimin e tij. Nga ligji bazik janë nxjerrë këto aktet nënligjore: Udhëzimi Administrativ Nr.03/2010 për procedurat e aplikimit për njohjen e të drejtave në aftësim, riaftësim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara; Udhëzimi Administrativ Nr.09/2010 për përcaktimin e vendeve të punës dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara në përputhje me aftësitë e tyre të punës; Udhëzimi Administrativ Nr.09/2012 për mënyrën dhe rregullat e mbajtjes së evidencës për punësimin e personave me aftësi të kufizuara; dhe Udhëzim Administrativ (MPMS) Nr.04/2014 për procedurat e përkrahjes institucionale për arsimin, riaftësimin dhe përgatitjen profesionale të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara. Siç po shihet nga vetë numrat e akteve nënligjore, këto akte janë nxjerrë me shumë vonesa, madje deri në 6 vite vonesa.

Edhe në ligji për ndryshimin dhe plotësimin, është paraparë nxjerrja e të paktën katër akteve të reja nënligjore, por tani ka kaluar më shumë se një vit dhe akoma nuk është nxjerrë asnjëri prej tyre.

Sa i përket zbatimit të këtij ligji, dispozitat më të rëndësishme të tij nuk po gjejnë zbatim, siç është neni 12 i cili ka caktuar se organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës ti punësojnë një personat me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor, pastaj punëtoritë mbrojtëse, qendrat punuese, mbledhja dhe administrimi i kontributeve të mbledhura nga punëdhënësit të cilët nuk respektojnë nenin 12, si dhe dispozitat për stimulimin material të punëdhënëseve (siç janë pagesat e kontributeve të obligueshme për të punësuarit).

Ky ligj konsiderohet si ligji më i pazbatuari në fushën e personave me aftësi të kufizuara, ndoshta edhe në përgjithësi. Nga mos zbatimi i këtij ligji, personat me aftësi të kufizuara sot janë të përjashtuar nga tregu i punës, nga pavarësia financiare dhe ekonomike, nga mirëqenia sociale dhe pjesëmarrja në shoqëri.

Në lidhje me zbatimin e këtij ligji, Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenia Sociale, në vitin 2013 e ka mbikëqyrë zbatimin e këtij ligji dhe ka nxjerrë një raport me rekomandime të cilin Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar.

Pas këtij raporti, Kuvendi i Republikës së Kosovës më 5 gusht 2016 e ka miratuar Ligjin Nr. 05/L - 078 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, ndërsa tani edhe pas një viti nuk ka asnjë përmirësim të zbatimit të tij dhe as përmirësim të punësimit të personave me aftësi të kufizuara.

#### **LIGJI Nr. 05/L-025 PËR SHËNDETIN MENDOR**

Ky ligj është miratuar më 24 tetor 2015, ndërsa ka hyrë në fuqi në gjysmën e dhjetorit 2015.

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve

që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore, ndërsa fushëveprimi i tij është përcaktimi i procedurave, kushteve për mbrojtjen e shëndetit mendor nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, mjedisit social të përshtatshëm për personat me çrregullime mendore dhe politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Ligji ka paraparë nxjerrjen e të paktën gjashtë (6) akteve nënligjore të cilat e lehtësojnë zbatimin e tij dhe ka caktuar afatin prej një (1) viti për nxjerrjen e tyre, të cilat do të rregullonin çështjet e i Komisionit psikiatriko–ligjor; shërbimet në institucionet rezidenciale të përkujdesit social; fushëveprimi, kompetencat, përbërja dhe mandati i Komisionit të mjekëve specialist tek dispozita e trajtimit të pavullnetshëm; rregullat e organizimit dhe të funksionimit të shërbimeve të shëndetit mendor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale; kompetencat, përbërja si dhe mandati i Këshillit Profesional për Shëndetin Mendor.

Deri në kohën e hartimit të këtij raporti, në Gazetën Zyrtare tek aktet nënligjore të këtij ligji nuk figuron asnjë akt nënligjor i publikuar, me çka lë të kuptohet se nuk është nxjerrë asnjë prej tyre.

## **LIGJI NR. 03/L-022 PËR PËRKRAHJE MATERIALE FAMILJEVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR TË PËRHERSHME**

Ky ligj është miratuar më 16 maj 2008, ndërsa është shpallur nga UNMIK-u më 14 qershor 2008, pra ligji më i vjetër në fuqi për personat me aftësi të kufizuara..

Me këtë ligj rregullohet e drejta për përkrahje materiale familjeve të cilët ruajnë dhe përkujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuar të përhershme dhe mënyra e realizimit të kësaj përkrahje materiale.

Ligji nuk ka përcaktuar numrin e akteve nënligjore që duhet nxjerrë dhe as nuk ka caktuar shumë çështjet të cilat duhet rregulluar më tej me akte nënligjore, por e ka autorizuar Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të nxjerrë ato të cilat e mundësojnë zbatimin e ligjit, në afatin prej gjashtë muajsh nga dita e miratimit të këtij ligji.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, për këtë ligj e ka nxjerrë vetëm një akt nënligjor, Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2009 për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të aplikimit

për realizimin e të drejtës në ndihmë materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, i plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2010 dhe vitin 2014, ndërsa hartuesi i këtij raporti nuk mundur të gjejë nëse janë nxjerrë aktet nënligjore të përcaktuara me ligj, njëri për caktimin e lartësisë dhe afateve për dhënien e ndihmës materiale dhe tjetri për caktimin e lartësisë së shumës mujore për përkrahje materiale familjes së fëmijës me aftësi të kufizuar të përhershme.

Përveç ndarjes së një shume mujore e cila aktualisht është 100 Euro, ligji nuk ka rregulluar shumë çështje tjera për fëmijët me aftësi të kufizuara, andaj edhe nuk ka shumë vërejtje për zbatimin e tij. Vërejtjet kryesore janë për shumën mujore e cila është caktuar në mënyrë lineare për të gjithë fëmijët, pa u bazuar në nevojat dhe në llojin apo shkallën e aftësisë së kufizuar, si dhe për efikasitetin dhe respektimin e afateve të mjeteve juridike, të cilat shkelen. Ka raste kur prej momentit të paraqitjes së kërkesës për njohjen e të drejtës për mbështetje materiale e deri te realizimi i saj, kalon kohë deri në 2 vite, nëse procedura vazhdohet me ankesa dhe padi.

## **LIGJI NR. 04/L-131 PËR SKEMAT PENSIONALE TË FINANCUARA NGA SHTETI (dispozitat përkatëse për personat me aftësi të kufizuara)**

Deri më 20 qershor të vitit 2014, pensionet e personave me aftësi të kufizuara ishin të rregulluara me Ligjin Nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara (Rregullorja

e UNMIK-ut Nr. 2003/40), ndërsa me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, u shfuqizua Ligji Nr.2003/23.

Që nga 20 qershori i vitit 2014, pensionet e personave me aftësi të kufizuara janë Ligjit Nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, përkatësisht në dispozitat e nenit 9, e cila e emërton si pensioni i pa aftësisë të përhershme, e që përkufizon si pension të rregullt mujor i paguar për qytetarët e Republikës së Kosovës, bazuar në vendimin e organit përkatës të Ministrisë, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me këtë ligj.

Kjo dispozitë e ligjit rregullon kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension të pa aftësisë të përhershme, si mbështetje financiare për personat me aftësi të kufizuara nga mosha tetëmbëdhjetë (18) deri gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç, vetëm për personat të cilët do të konsiderohet me pa aftësi të përhershme, ndërsa me paaftësi të përhershme konsiderohet personi i cili ofron dëshmi se është me pa aftësi të përhershme para se të aplikojë për pension, duke siguruar të gjitha dëshmitë mjekësore.

Sa i përket nxjerrjes së akteve nënligjore, të cilat mundësojnë zbatimin e dispozitave përkatëse për personat me aftësi të kufizuara, ligji e ka lënë të përcaktohen me akt nënligjor, procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë të përhershme. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, më 31 dhjetor të vitit 2015 e ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.06/2015 për procedurat e aplikimit dhe vlerësimit për pensionin e paaftësisë së përhershme, pra me një vit vonesë nga afati të cilin e ka caktuar ligji.

Ky ligj, përveç pensionit nuk rregullon ndonjë të drejtë tjetër për personat me aftësi të kufizuara, për të cilat do ishte e nevojshme nxjerrja e akteve tjera nënligjore dhe në këtë drejtim as nuk është sfiduar shumë zbatimi i dispozitave përkatëse për personat me aftësi të kufizuara.

Vërejtjet kryesore janë për shumën mujore të pensionit e cila aktualisht është 75 Euro, është e caktuar në mënyrë lineare për të gjithë, pa u bazuar në nevojat dhe në llojin apo shkallën e aftësisë së kufizuar, si dhe për efikasitetin dhe respektimin e afateve të mjeteve juridike, të cilat shkelen.

Ka raste kur prej momentit të paraqitjes së kërkesës për njohjen e të drejtës për pensionin e aftësisë së kufizuar, të cilin ligji e quan pension i paaftësisë së përhershme e deri te realizimi i saj, nëse procedura vazhdohet me ankesa dhe padi, kalon kohë me së paku deri në 2 vite, madje deri në 4 vite, deri në realizimin e të drejtës. Në lidhje me këtë edhe Avokati i Popullit e ka nxjerrë një raport, në të cilin ka gjetur se me procedurat e vazhdueshme që janë të detyruar të ndjekin, por pa një vendim meritore dhe pa një shqyrtim të përshtatshëm gjyqësor është



shkelje e të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara (Raporti Ex-Officio nr. 425/2015)<sup>1</sup>.

Po ashtu edhe afatizimi i vendimeve në 1, 3 ose 5 vjet, po paraqet shumë vështirësi tek personat me aftësi të kufizuara. Në rastet kur një person ka realizuar pensionin e aftësisë së kufizuar për më shumë se 5 vite, me rastin e rivlerësimit iu ndalen pensioni pa dhënë ndonjë arsyetim të bazuar dhe të qartë. Shpesh herë personat me aftësi të kufizuara pyesin se si është e mundur të kem qenë me aftësi të kufizuara për 5 – 10 vite, e pas kësaj periudhe të mos jem më.

---

<sup>1</sup> [http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/425-2015\\_Raport\\_ne\\_lidhje\\_me\\_mungesen\\_e\\_mjeteve\\_efektive\\_juridike\\_982052.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/425-2015_Raport_ne_lidhje_me_mungesen_e_mjeteve_efektive_juridike_982052.pdf)

## **LIGJI NR. 02/L-17 PËR SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILJARE, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR.04/L-081**

Ky ligj nuk rregullon shërbimet sociale dhe familjare vetëm për personat me aftësi të kufizuara, por është ligj shumë me rëndësi për mirëqenien sociale të personave me aftësi të kufizuara dhe është në fuqi që nga viti 2005, ndërsa është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2012.

Ligji përcakton dhe rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë dhe familjet që janë në nevojë në Kosovë. Në rrethanat kur nuk ka përkrahje nga familja ose kur ajo nuk është e mjaftueshme për të siguruar mirëqenien e një individi, shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare për ata njerëz që ndryshe nuk do të ndihmoheshin në mënyrën, e cila do të respektonte dinjitetin e tyre si qenie njerëzore dhe të drejtat e tyre themelore të bazuara në legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

Sipas ligjit, person në nevojë nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale, ndër tjera edhe për shkak të sëmundjes trupore ose aftësive të kufizuara fizike, të aftësive të kufizuara mendore, të sëmundjes mendore.

Për zbatim të këtij ligj janë nxjerrë disa akte nënligjore, por sa i përket ofrimeve të shërbimeve për të gjitha llojet e aftësisë së kufizuara, ligji nuk ka gjetur zbatim. Komunitet nuk ofrojnë të gjitha shërbimet e nevojshme për të gjitha llojet e aftësisë së kufizuar as nuk i kontraktjnë organizatat që i ofrojnë ato shërbime. Deri më tani asnjë institucion nuk i ofron pajisjet ndihmëse, siç janë karrocet, nuk ofrohen rehabilitimet e nevojshme, nuk ka financim të qëndrueshëm nga shteti për organizatat joqeveritare që ofrojnë shërbime dhe për këtë arsye organizatat shpesh herë e ndërpresin dhënien e shërbimeve. Një tjetër vështirësi për zbatim të këtij ligji sa i përket ofrimit të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara është edhe mos rregullimi i çështjes së financimit të shërbimeve sociale dhe familjare, përkatësisht mos caktimi i grantit për shërbimet sociale për komunitet.

Me shumë vite vonesë, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, përmes Këshillit të Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare, ka bërë licencimin e ofruesve të shërbimeve sociale dhe familjare, licencim i cili duhet të ketë efekt në rritjen e cilësisë dhe standardeve të shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara.

## LIGJET E FUSHËS SË ARSIMIT

Ligji Nr. 02/L-52 mbi edukimin parashkollor; Ligji Nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës; Ligji Nr.04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës; Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës; Ligji Nr. 05/L-018 për provimin e maturës shtetërore (dispozitat përkatëse për personat me aftësi të kufizuara)

Edukimi dhe arsimi i personave me aftësi të kufizuara është e drejtë themelore e njeriut e garantuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe me konventat ndërkombëtare. Ligjet e para, edhe pse të miratuara para hyrjes në fuqi të Kushtetutës në vitin 2008, kanë standarde të larta për mbrojtjen nga diskriminimi të personave me aftësi të kufizuara në fushën e edukimit dhe arsimit. Po ashtu edhe ligjet tjera të miratuara pas vitit 2008, për nga përmbajtja janë shumë të avancuara për të drejtën e personave me aftësi të kufizuara.

Ligjet e fushës së arsimit janë të shoqëruara me numër të madhe të akteve nënligjore, por në praktikë, edukimi dhe arsimi i personave me aftësi të kufizuara ka hasur në vështirësi të mëdha, shumë dispozita të rëndësishme nuk zbatohen, komunat nuk ndajnë buxhet, objektet e shkollave dhe universiteteve janë kryesisht të pa qasshme për përdoruesit e karrocave, mungojnë shërbimet e nevojshme në shkolla siç janë asistentët për fëmijët me aftësi të kufizuara, ka vështirësi në transportin shkollor, ekipet vlerësuese nuk janë themeluar në të gjitha komunat si dhe aty ku janë themeluar ato janë bërë me shumë vonesë, etj.

Se Institucionet nuk po ofrojnë mundësi të barabarta për edukim dhe arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara, janë raportuar edhe në raportet e Avokatit të Popullit<sup>2</sup>, Komisionit Evropian<sup>3</sup> dhe të Departamentit Amerikan të Shtetit<sup>4</sup>.

---

2

[http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti\\_vjetor\\_SHQIP\\_nr16\\_me\\_kopertine\\_per\\_web\\_204801.pdf](http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_vjetor_SHQIP_nr16_me_kopertine_per_web_204801.pdf)

<sup>3</sup> [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/20161109\\_kosovo\\_report\\_2016\\_alb.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/20161109_kosovo_report_2016_alb.pdf)

<sup>4</sup> <https://www.state.gov/documents/organization/265648.pdf>

## **LIGJET E FUSHËS SË SHËNDETËSISË:**

Ligji Nr. 04/L-125 për shëndetësi dhe Ligji Nr. 04/L -249 për sigurimin shëndetësor (dispozitat përkatëse për personat me aftësi të kufizuara)

Shërbimet shëndetësore, llojet dhe cilësia e tyre janë shumë të rëndësishme për personat me aftësi të kufizuara. Ligjet e fushës së shëndetësisë në parim garantojnë mos diskriminim dhe trajtim të barabartë për personat me aftësi të kufizuara në shërbimet shëndetësore, por nuk kanë përcaktuar obligime të veçanta për shtetin për ofrimin e shërbimeve specifike.

Andaj, në institucionet shëndetësore publike nuk ofrohen shërbimet specifike për personat me aftësi të kufizuara, objektet shëndetësore janë kryesisht të pa qasshme për personat përdorues të karrocave (edhe pse spitalet e kanë obligim të kenë qasje sipas Udhëzimit Administrativ (MSH) Nr.06/2015 Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta Spitalore), pastaj mos fillimi i sigurimeve shëndetësore po ashtu po ndikon edhe te personat me aftësi të kufizuara, pasi që sipas ligjit për sigurimin shëndetësor do të lirohen nga pagesa e premiumit etj.

Niveli më i lartë i mos zbatimit të legjislacionit në fushën e shëndetësisë, është mos zbatimi i Udhëzimit Administrativ Nr.03/2012 për Menaxhimin e Materialit të Inkontinencës për personat me aftësi të kufizuara, i nxjerrë në vitin 2012.

## **LIGJET TJERA**

*Ligji Nr. 04/L – 110 për ndërtim / Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara*

Liria e lëvizjes është e drejtë themelore e çdo qytetari, e njohur dhe e garantuar me Kushtetutë dhe me konventa ndërkombëtare. Liria e lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara nuk mund të paramendohet pa infrastrukturë të qasshme. Qasja për personat me aftësi të kufizuara përfshinë por nuk kufizohet, në objekte me standarde të qasjes, rrugë, trotuare, sheshe dhe hapësira tjera publike të qasshme, shkolla, spitale dhe institucione të qasshme.

Ligji për ndërtim i cili ka për qëllim i këtij ligji është përcaktimi i kornizës ligjore e cila rregullon lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit brenda territorit të Republikës së Kosovës, ndërsa si fushë të zbatimit e ka rregullimin e ndërtimit të të gjitha objekteve ndërtimore në Kosovë, projektimin, ndërtimin, rindërtimin, rrënimin, nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj të veçantë.

Ky ligj ka parime dhe dispozita që garantojnë nderimin e objekteve ndërtimore të qasshme për personat me aftësi të kufizuara, e të cilat janë paraparë që më në detaje të rregullohen me Kodin e ndërtimit, si një akti nënligjor që parasheh vendosjen e kërkesave minimale për adresimin e fuqisë strukturore, hapësirave të emergjencës, sanitarisë, ndriçimit adekuat dhe ventilimit, qasjes, ruajtjen e energjisë dhe sigurinë e jetës në lidhje me objektet e reja dhe ato ekzistuese, për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë dhe mirëqenien e përgjithshme të banorëve. Do të bazohet në standardet ndërkombëtare dhe do të përfshijë norma teknike të përshtatura për Kosovën.

Edhe pse ky ligj është në fuqi që nga viti 2012, ku Kod nuk është nxjerrë, ndërsa aktet tjera nënligjore nuk kanë arritur të ofrojnë garancinë për ndërtime të qasshme për personat me aftësi të kufizuara.

Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara, është në fuqi që nga viti 2007. Ky Udhëzim Administrativ rregullon kushtet teknike dhe mënyrat e sigurimit të qasjes së papenguar, lëvizjes, qëndrimit dhe punës së personave me aftësi të kufizuar dhe modernizimit të qasjes në objektet ndërtimore publike për destinim pune, banimi dhe banesor-afariste, si dhe kushtet dhe mënyra e përshtatshmërisë së thjeshtë të qasjes në objektin ndërtimor me destinim banimi dhe banesor-afarist.

Edhe përkundër ligjit dhe udhëzimit administrativ Nr. 33/2007, në Kosovë vazhdohet të ndërtohen objekte me destinim publik të pa qasshme, personave me aftësi të kufizuara po vazhdohet t'u mohohet liria e lëvizjes, e në këtë drejtim ju mohohet e drejta në arsim, punësim etj.

*Ligji Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256 (dispozitat përkatëse për personat me aftësi të kufizuara)*

Ky ligj garanton të drejtën e zgjedhjes për të gjithë qytetarët me të drejtë vote, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara. Ligji ka dispozita për votim të personave me aftësi të kufizuara, të cilët nuk mund të votojnë personalisht në vendvotimin në të cilën janë caktuar për Ditën e Zgjedhjeve, madje për këtë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka nxjerrë Rregullën Zgjedhore Nr.04/2013 Votimi i Personave me Nevoja dhe Rrethana të Veçanta.

Vërejtja kryesore për mos zbatim të këtij ligji dhe ligjit për zgjedhjet lokale është mungesa e qasjes për personat me aftësi të kufizuara në Qendrat e Votimit, përkatësisht në Vendvotime, deri vonë ka qenë edhe mungesa e fletëvotimeve për personat e verbër.